



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Rahovec, e mbajtur më 09.06.2021 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Kryetari- Më lejon i'i përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKS, Nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtorët e Drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e dytë rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2021 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;
 - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit;
 - Planit operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave;
 - Siguria në Trafik;
 - Gjendja e sigurisë në shkolla;
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla;
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelesve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar;
5. Të Ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Kryetari – Do i japë disa informatë sa i përket situatës me Covid – 19 në Komunën e Rahovecit. Sot jemi me datën 09.06.2021, ne në komunën tonë kemi zero raste pozitive, ne nuk e dimë se çka do të ndodhë

nesër, por ne aktualisht jemi me zero raste. Situata aktuale është 1172 raste të shënuara, 72 raste kanë përfunduar me fatalitet dhe zero raste pozitive. Ne jemi duke vazhduar që të adresojmë situatën edhe më tutje, ne nuk guxojmë të mendojmë që ka përfunduar gjithçka dhe duhet të i kryejmë ato veprime të cilat janë të nevojshme që situata me Covid – 19 të jetë stabile. Kemi disa mungesa për sa i takon vaksinimit ë popullsisë, me datën 15 qershor në është thënë se do të filloj vaksinimi masiv i popullsisë, se cilat do të jenë modalitetet e zbatimit të këtij procesi mbetet të shihet, por shumëçka varet nga MSH-së. Ne si komunë kemi kërkuar nga MSH-së që të kemi edhe dy qendra të tjera për vaksinim përveç Rahovecit, pra të jetë Krusha e Madhe dhe Ratkoci, por kjo kërkesë e jona është refuzuar nga ana e tyre, me arsyetimin që vaksinimi duhet të ndodhë vetëm në një qendër. Për momentin nuk janë duke vazhduar vaksinimi, për arsye që ka mungesë të shiringave, por edhe këto shiringa vinë nga ministria, shpresojmë se shumë shpejtë do vinë dhe ne do të vazhdojmë me vaksinimin e popullatës. Testimi me testet rapide është duke vazhduar, poashtu dezinfektimi i objekteve shëndetësore vazhdon, siç jeni duke parë edhe ju se respektimi i distancës dhe vënia e maskës shumë më pak është duke u respektuar, ndoshta edhe pse është duke ardhur një situatë duke u përmirësuar, por duhet të dimë se në fuqi janë ende disa kufizime. Ju ftoj si anëtar të KKS-së që jeni ta luani rolin tuaj dhe ti bëni thirrje qytetarëve që ta bëjnë vaksinimin sepse nëse nuk vaksinohen ka gjasa që të kenë kufizime në lëvizje jashtë shtetit. Ju falënderoj, tani debati është i hapur fjala është e juaja.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, siç e ceku edhe kryetari rastet aktive në komunën tonë janë zero për momentin, po ju japë një informatë të shkurtër sa i përket vaksinimi të popullatës sonë. Deri më tani në komunën tonë janë të vaksinuar rreth 2022 qytetar, 1404 qytetar janë vaksinuar me vaksinën Astrazeneca, kurse 618 qytetar me vaksinën Pfizer. Aktualisht i kemi në dispozicion rezervë rreth 400 vaksina, që sipas rekomandimeve të MSH-së duhet të ruhen për dozën e dytë për qytetarët që janë vaksinuar në fazën e parë, por aktualisht janë pezulluar vaksinimet nga MSH-së, për shkak të mungesës së shiringave. Në çdo moment kur të na sjellin shiringat, ne si drejtori e shëndetësisë jemi të gatshëm që të vazhdojmë me vaksinimin e popullatës.

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit. Sipas gjitha informatave dhe burimeve që i kemi, gjendja në Komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, me disa incidente të vogla për të cilat nuk duhet diskutuar. Sa i përket problemeve ndëretnike nuk kemi pasur, ndonjë rast të raportuar sa i përket problemeve ndëretnike. Për më shumë fjalën ja kalojë komandantit të stacionit të policisë z. Fazli Morina, që të na raportoj për situatën e sigurisë në Komunën e Rahovecit. Por kjo nuk do të thotë që ne në komunën tonë nuk kemi angazhime, ngjarje, delikuenca, incidente, kundërvajtje, vepra penale të vogla, por për të gjitha këto sigurisht që do na thotë pak më shumë komandanti i policisë.

Fazli Morina - Komandanti i policisë, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, situata e sigurisë në përgjithësi në komunën tonë mbetet e qetë dhe stabile. Sa i përket situatës së pandemisë Covid – 19 në komunën tonë kryetari e dha një përmbledhje, por edhe ne si polici jemi duke vazhduar në implementimin e planeve operative dhe respektim të vendimeve të qeverisë për zbatimin e të gjitha masave ashtu siç kërkohen. gjatë periudhës raportuese, të gjitha njësitet e S.P. Rahovec, të asistuar sipas nevojës edhe nga patrullat policore të NJSO-se dhe NJRKRR-se, kanë qene të angazhuara në implementimin e Planit Operativ të DRP-se Gjakove, për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus COVID-19", duke vepruar në përputhje me vendimet e Qeverisë dhe zhvillimeve tjera aktuale, për menaxhimin e situatës së pandemisë, në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Në kuadër të këtij plani, gjatë periudhës raportuese, ne S.P Rahovec janë regjistruar statistikat e aktiviteteve policore si ne vijim; Janë shënuar 704 gjopa bazuar në Ligjin NR 07/L-006, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, prej tyre 595 gjopa për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 104 gjopa për mos respektim të orarit lëvizjes dhe 5 gjopa për organizime të ndaluara.

Siguria në Trafik - Situata e sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Rahovecit, gjatë kësaj periudhe, ka qene e qetë dhe stabile.

Gjatë kësaj periudhe, ne S.P. Rahovec janë regjistruar gjithsej: 68 Raste, prej tyre 68 vepra penale dhe 0 incidente të ndryshme. -Vjedhje 13 raste, vjedhje të rënda 14 raste, dhunë në familje 4 raste, armë mbajtje pa leje 1 rast.

Nga këto raste mund të veçojmë disa vepra më të rënda: - Grabitje në një pompe të derivateve në fsh. Çifllak, e ndodhur me datë 23.05.2021, e cila është hetuar dhe zbuluar, i dyshimti është arrestuar. Disa vjedhje serike në fsh. Opterush që kanë ndodhur gjatë javës së kaluar, kryesisht në shtëpitë e pa banuara, pronaret e të cilave gjenden jashtë vendit. Po ashtu është shqetësuese një dukuri në qytetin e Rahovecit, breddhja neper qytet ne orët e vona i një grupi të personave të dyshimte të mitur, të cilët kanë shkaktuar një seri incidentesh dhe vepra penale, si; dëmtimi i disa kamerave të sigurisë në qytet, marrja dhe dëmtimi i karrocës së invalidëve në Emergjencën e QKMF-së "Fahredin Hoti"- në Rahovec, vendosja e pengesave në rrugë etj. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale në Gjakovë, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme. Siguria në komunikacionin rrugor - Policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme për ngritjen e sigurisë në komunikacion, për të mundur dhe përmirësuar lëvizjen e lirë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion. Gjatë periudhës raportuese nga policia e s.p. Rahovec, janë shënuar 494 gjopa për kundërvajtje në komunikacionin rrugor dhe pesë (5) kundërvajtje për PRQP. Siguria në shkollë - Policia e Kosovës në vazhdimësi është e përkushtuar lidhur me sigurinë në objektet shkollore, ku gjatë periudhës raportuese, janë bërë vizitat në shkollë dhe kontaktet me kuadrin arsimor, njëkohësisht edhe pika të kontrollit afër shkollave të zonës tone të përgjegjësisë. Vazhdon implementimi i Planit Operativ "Siguria në Shkollë" 2020/2021, me aktivitete policore për shtimin e masave të sigurisë për nxënës dhe kuadrin arsimor. Sa i përket rasteve në shkollë, gjatë periudhës raportuese, në shkollat e zonës tone të përgjegjësisë, është raportuar vetëm një rast "Lëndim i lehtë trupor" i cili ka ndodhur në shkollën fillore "Bekim Sylka" në Rahovec me datën 14.05.2021. Rasti në konsultim me Prokurorin e Shtetit, ka shkuar në procedurë të rregullt.

Aktivitetet tjera - Ka vazhduar implementimi i Projektit "Bombolat e gazit vrasin", janë vizituar dhe inspektuar disa pompa të derivateve që merren me shitjen e gazit në zonën tone të përgjegjësisë, aktivitete të cilat janë evidentuar në raport të veçantë. Është implementuar dhe ka përfunduar faza e parë e projektit "Kamerat e sigurisë", për qytetin e Rahovecit dhe fshatin Xërxe, nga kompania "Tetroniks", nënkontraktuese janë vendosur, instaluar, janë testuar dhe janë vure në funksion gjithsej 55 kamera statike, rrotulluese dhe funksione tjera, 50 kamera janë vendosur në qytetin e Rahovecit në lokacione të ndryshme sipas nevojës në vendet me të frekuentuara ndërsa 5 kamera janë vendosur në udhëkryqin kryesor dhe afër udhëkryqit në fshatin Xërxe, ndërsa pajisjet përcjellëse të kamerave të sigurisë janë vendosur në objektin e zyrës së vendit në dhomën e arkives së ofiqaris. Po ashtu në hapësirën e dhomës të radio komunikuesi në S.P. Rahovec, janë vendosur dhe montuar gjashtë (6) monitor, të dedikuar për ndërlidhje me kamerat e sigurisë, të cilët do të shërbejnë për monitorimin e situatës së sigurisë në lokacione të cekura. Gjatë punimeve për vendosjen e kamerave, kompania kontraktuese, ka hasur në pengesë nga inspektorët e komunës së Rahovecit, që sipas tyre ju është shënuar një procesverbal. Fjala është e juaja të nderuar anëtar të KKSB-së.

Fadil Sylka – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pyetje ime është për komandantin, i nderuar a ekzistojnë qendrat për riedukim të të miturve, nëse po atëherë pse nuk jeni duke vepruar me ata të mitur që bëjnë probleme, besoj se do të ndikonte shumë nëse këta të mitur do të përcillen në këtë qendër.

Fazli Morina – I nderuar pyetje juaj është shumë me vend, i nderuar detyra e jona si polici është ti identifikojmë, ti zbulojmë, ta komplotojmë rastin dhe pastaj ta dërgojmë në instancën tjetër në bashkëpunim me QPS-në dhe prokurorin. Nëse si polici e kemi kryer punën tonë, të angazhuar kanë qenë edhe QPS-ja edhe pse puna nuk është kryer edhe pse me keqardhje po e them sepse në kemi të drejtë ta ja shkruajmë edhe një gjopë prindërve për mos mbikëqyrje. Qendra është në Lipjan por kjo nuk varet nga ne sepse nga ne është kryer çdo gjë.

Ramë Berisha – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, na vije mirë që siguria në vend është e qetë, poashtu edhe na vije mirë që policia dhe organet e tjera që kontribuojnë në siguri janë duke u angazhuar pa u ndalur që ne të kemi një jetë sa më të qetë. Takimet e këtij lloji janë të mirëseardhur për ne sepse ne si anëtar të këtij takimi jemi të informuar me gjendjen në Komunën tonë.

Ylvi Shehu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam disa shqetësime, por së pari do ja filloj nga vetja, rruga Ali Sokoli, tek udhëkryqi i Shaban Ose, është punuar kanalizimi në këtë lagje, ku janë vendosur gypat

F-500, ky kanalizim kalon tani tek rruga e lagjes Hoxha ku në këtë lagje gypat janë F-18. Çdo shi që bije puseta e fundit mbushet dhe qohet dhe komplet rruga ku jemi rreth 10 shtëpi, poashtu edhe rruga "Xhelal Hajda - Toni" deri tek semaforët, mbushet me ujëra fekale. Arsyeja është se puseta që është tek xhami kadiri është e bllokuar dhe ne si lagje jemi të rrezikuar nga sëmundjet e ndryshme, tani po vije edhe stina verës dhe do të kundërmoj erë shumë e keqe. Si shqetësim i dytë është tek rruga "Ali Sokoli", ekziston një shtyllë elektrike që e bllokoi rrugën dhe komunikacionin, nuk mundën dy makina të kalojnë në të njëjtën kohë. Poashtu e kam edhe një shqetësim, por më shumë propozim, rruga që të qon tek shkolla fillore "Isa Boletini", kjo rrugë është dy kahëshe, por në njërin anë parkohen makinat, por ne që i dërgojmë nipat ose fëmijët në shkolla shpesh herë jemi të bllokuar në këtë rrugë. Ju kisha lutë që të dilni me ekspertët tuaj të komunikacionit dhe të shkoni dhe të bëjnë një zgjidhje.

Sihana Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryetar edhe unë e kam një shqetësim sa i përket rrugës "Gëzim Hamza - Piktori", kjo rrugë është shumë e frekuentuar me vetura, problemi i kësaj rruge është që nuk ka trotuare, në këtë rrugë frekuentojnë nxënësit e dy shkollave të mesme dhe një fillore, por për fat të keq të gjithë nxënësit janë dukur ecur në rrugë. Nga SHL Kosova deri tek shkolla e mesme "Xhelal Hajda - Toni", është krijuar një hapësirë e mirë e trotuarit, por ajo që na shqetëson neve është se aty janë duke u parkuar veturat dhe përsëri trotuarët janë të zëna. Kërkesa ime është nëse ka mundësi të vendosen disa pengesa në këto trotuare në mënyrë që mos të kenë të mundur të i parkojnë veturat.

Shaip Shala – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek kjo pikë e kemi edhe një nën pikë Masat për parandalimin e lëmosh kërkuesve, për këtë dukuri negative kam diskutuar edhe nëpër mbledhje tjera. I nderuari komandant kam informata që çdo mëngjes një furgon i lëshon para podrumit Haxhijaha, hiq më larg se sot Rahoveci është vërshuar nga këta lëmosh kërkues, i sheh nëpër lokale nga dy tre duke kërkuar. Pyetje ime për komandantin është nga mbledhja e kaluar që e kam ngritë këtë shqetësim e deri më sot çfarë masa keni marr, jam plotësisht i bindur se ka është një krim i organizuar.

Kryetari – Ju falënderoj për pyetjet e parashtruara, tani besoj se komandanti do ju përgjigjet pyetjeve.

Fazli Morina – Ju faleminderit për pyetjet e bërë, i nderuari Shaip ky është një problem që na shqetëson të gjithëve, por besoj se 99% nga ne kur hasim tek ta jemi duke i dhënë, për mua kjo nuk është në rregull. Sa i përket veprimeve që i kemi ndërmarr ne si polici ndaj kësaj dukurie, për momentin nuk mundem me ti dhënë sepse nuk kam ndonjë statistikë, por lirishtë mundem të them se këta persona janë sjellë në stacion, me procedurë të shpejtë ju është dorëzuar rasti gjykatës dhe është marr vendim për largim nga shteti. Por ajo që dua të them se në Rahovec ka shumë pak lëmosh kërkues, këtë e them me një krahasim me Prizrenin, në Prizren nuk mundesh të lëvizësh këmbën nga lëmosh kërkuesit, prandaj lëmosh kërkuesit në Rahovec nëse e krahasojmë me Prizrenin është zero. Por sidoqoftë ne punën tonë ne duhet të bëjmë, linja jonë është e hapur 24 orë dhe ne presim bashkëpunim si me ju anëtar të KKS-së, poashtu edhe qytetarët e tjerë, besoj se bashkërisht mundemi me e eliminu këtë problematik.

Kryetari – Do i përgjigjem disa pyetjeve që janë parashtruar, sa i përket shtyllës tek rruga "Avdullah Bugari", tek semaforët e dytë, ne me këtë të KEDS-it mundemi të themi edhe kemi raporte edhe s'kemi, por ne nga ta nuk kemi veprime të mjaftueshme që të na i kryen disa punë, ne ja kemi drejtuar një shkresë sa i përket asaj shtylle, ne përsëri do ti drejtohem KEDS-it me një shkresë që ta largojnë atë shtyllë nga ajo rrugë. Sa i përket rrugë tek "Isa Boletini", ne atë rrugë kemi dashur ta rregullojmë dhe ta bëjmë një kahëshe, por banorët e asaj rruge nuk kanë lejuar, por ne duhet të mos i pyesim dhe ta bëjmë atë rrugë një kahëshe. Kur të bëhet rruga një kahëshe do të ketë edhe parking, unë nga këtu po e obligoj drejtorin e shërbimeve publike, që së bashku me policinë dhe tjerët që duhet të jenë me ta, të shkojnë dhe të shikojnë mundësit që ajo rrugë të bëhet rrugë një kahëshe. Sa i përket pyetjes së Sihana Durakut, është e vërtetë që ne i kemi bërë disa trotuare afër shkollës së mesme "Xhelal Hajda - Toni", besoj se drejtori Avni Morina duhet të marrin masa dhe të fillojnë me shenjëzimin e trotuareve dhe vendosjen e pengesave në mënyrë që mos të parkohen makinat sepse ajo nuk është parking por trotuar. Ne e kemi futë në projekt ri trajtimin e kësaj rruge, me ujërat atmosferik dhe gjërat përcjellëse, kjo rrugë do të bëhet me standarde tjera, poashtu edhe 8 rrugë të tera në qytet së shpejti hapen ofertat. Sa i përket kamerave të sigurisë në qytet dua ta falënderoj Fatmir Isken dhe Përparim Krasniqin të cilët janë marrë me organizatën e cila na ka përkrah në këtë projekt, 55 kamera të sigurisë kanë një efekt të jashtëzakonshëm për sigurinë e qytetit dhe shumë e shumë efekte tjera.

Ne nuk kemi biseduar edhe për disa nënpika, besoj se këtë vite do të kemi shumë mërgimtar, për arsye se vitin e kaluar nuk kanë qenë dhe masat janë më të zbutura, por ne duhet të kemi një plan të përbashkët me policinë sepse do të kemi edhe ne si komunë aktivitete, por policia duhet të ketë më shumë vëmendje tek aksidentet në trafik, lokalitetet e natës. E lusë Përparim Krasniqin të i jep disa përgjigje rreth pyetjeve të parashtruara nga z. Ylvi Shehu.

Përparim Krasniqi - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket rrugës Ali Sokoli dhe Faredin Hoxha, ne së bashku me Ministrin e Infrastrukturës e kemi një projekt për asfaltimin dhe riasfaltimin e disa 10 rrugëve në qytet, në kuadër të këtyre rrugëve janë të përfshirë edhe këto dy rrugë. Rruga Ali Sokoli dhe Faredin Hoxha do të demolohehen komplet, do të vendosen instalimet nëntokësore të reja, duke përfshirë edhe ndriçimin publik, do të futet kanalizimi atmosferik dhe fekal dhe më pas do të vendoset asfalti i ri. Sa i përket shtyllës tek rruga Avduallah Buguri, është e planifikuar në kuadër të projektit që të bëhet zhvendosja e kësaj shtylle në bashkëpunim me KEDSI-in. Tani jemi në fazën e procesit të tenderimit, si të kryhen këto ja fillojmë me punën në këto rrugë. Kurse sa i përket parkingut tek rruga Isa Boletini, ne me planin e mobilitetit i kemi në plan që ti trajtojmë 3 rrugë dhe ti bëjmë një kahëshe, në një të ardhme të afërt me ekspertët e komunikacionit do ti trajtojmë këtë mundësi.

Kryetari – Desha të bëjë një plotësim, ne planin e mobilitetit e kemi kaluar në kuvend, kishte me qenë mirë që nesër ekspertët e policisë, përveç rrugës Gëzim Hamza – Piktori, sepse duhet një analizë më e mirë. Rruga Isa Boletini duhet shumë shpejtë të bëhet rrugë një kahëshe, nuk kmei nevojë ta pyesim kuvendin sepse kuvendi e ka votuar Planin e Mobilitetit, ne vetëm jemi duke e zbatuar atë që ka votuar kuvendi. kalojmë në pikën e radhës:

4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar.

Kryetari – Ne sipas planit të punë e kemi këtë pikë në rend dite, prandaj dhe e kemi sot në mbledhje, tek ne nuk kemi probleme as ndër-etnike, as ndër-kulturore dhe as ndër-fetare, ky është fakt i pamohuar. Ne kemi sfida por këto sfida nuk paraqesin ndonjë situatë problematike. Ka pasur disa tentativa të disa ekipeve që janë në kuadër të ashtuquajturës Kosova Metohi dhe ligës së serbis që kanë dashur të luajnë në Rahovec, MPB, MPJ, Policia e Kosovës dhe Federata e Futbollit të Kosovës, nuk i ka lejuar dhe nuk do ti lejoj as tash e tutje. Kosova ka një federatë të futbollit dhe vetëm me lejen e tyre mundën të vinë ekipe të caktuara që të luajnë sportet e ndryshme, kjo nuk do të thotë se ekipet nga Hoça e Madhe dhe nga lagja e epërme të nacionalitetit serb mos të luajnë me ekipe të ligave të ndryshme dhe rajonale, siç e dini ka pasur edhe disa aktivitetet sportive që janë zhvilluar me iniciativën e OSBE-së në palestër në Rahovec, poashtu mundemi të kemi përsëri, por kurrësi një ekip nga liga tjetër pa lejen e organeve tona.

Fazli Morina – Pasi e kemi edhe në rend dite, poashtu është përmendur edhe rasti i futbollit, tek ne është debatuar shumë, na kanë ardhur shumë kërkesa dhe shumë njoftime, lojërat të ndryshme janë mbajtur në Hoçë të Madhe në mes ekipeve, të formuar nga fshatarët dhe askush nuk i ka penguar, ditëve të fundit kanë qenë disa kërkesa të disa ekipeve që nuk janë të regjistruara në federatën e futbollit të Kosovës dhe është marrë vendim që të mos mbahen. Poashtu desha të cekim edhe një dukuri shqetësuese që është në lagjen e epërme, me gjithë respektin, para 4 dite kemi marr një mesazh përmes drejtorisë rajonale, ku një gazetar i një portali nga Mitrovica veriore më duket ka cekur se është shkruar një grafit në lagjen e epërme. Ne kemi shkruar me patrullë menjëherë, ku kemi vërtetuar që në një shtëpi në lagjen e epërme është shkruar: Kosovë je Kosovo dhe shkrimi Big Albania, si dhe data e shpallje së pavarësisë. Një shkrim i tillë është duke bërë mediatik pa kurrfarë pikë nevojë, ne të gjithë e dimë se e gjitha lagja e epërme është e stërmmbushur me shkrime të natyrave të ndryshme me përmbajtje nacionaliste. Përgjigja ime ka qenë mos të japim rëndësi një çështje e cila është shumë e pa rëndësishme edhe pse nuk kemi të dyshuar, por nuk mundemi të paragjykojmë, por dihet se këto gjëra i bëjnë huliganët rrugës qoftë nga nacionaliteti shqiptar ose serb. Unë vet kam qenë aty para këtij shkrimi në atë mure ka qenë e shkruar Kosovë je Serbia dhe ky shkrim askënd nuk e ka brengos, ne as që jemi marr me atë, kurse ky shkrim është duke i shqetësuar, prandaj i lusë mos të ngrisin çështje dhe të bëjnë problem të këtij lloji për këso shkrime qoftë ata të nacionalitetit serb apo nacionaliteteve tjera që jetojnë në atë lagje.


Kryetari – Ju faleminderit i nderuari komandant për përgjigjet e dhëna, kalojmë në pikën e fundit:

5. Të ndryshme.

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 17.10

Mbledhja ka përfunduar në orën: 16:35


Proccesmbajtës
Agim Hoti

